

NJOFTIM
Nr. 392, datë 12.1.2024

**PËR PUBLIKIMIN E FTESËS PËR OFERTË PËR “PROJEKTIMIN, FINANCIMIN,
NDËRTIMIN, OPERIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E DISA IMPIANTEVE
FOTOVOLTAIKE, SECILI ME NJË KAPACITET TË INSTALUAR NDËRMJET 10 mw
DHE 100 mw (PËRFSHIRË), TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASA
MBËSHTETËSE, ME VENDNDODHJE TË ZGJEDHUR NGA OFERTUESI NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në zbatim të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.6.2018, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të elektricitetit nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitim të tyre”, e ndryshuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur fillimin e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e projekteve për “Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e disa impianteve fotovoltaike, secili me një kapacitet të instaluar ndërmjet 10 mw dhe 100 mw (përfshirë), të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë”.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
FTESË PËR OFERTË

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë, Adresa: rr. “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

2. Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Z. Igli Perçuke, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

E-mail: igli.percuke@infrastruktura.gov.al

3. Forma, objekti dhe lloji i kontraktimit: Përzgjedhja e projekteve për “Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e disa impianteve fotovoltaike secili me një kapacitet të instaluar ndërmjet 10 dhe 100 mw (përfshirë), të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë”.

Pjesëmarrja në këtë proces konkurrues lejohet vetëm për projekte me një kapacitet minimal prej 10 mw dhe kapacitet maksimal prej 100 mw. Nëpërmjet këtij procesi konkurrues autoriteti kontraktues do të përzgjedhë projekte me një kapacitet të përgjithshëm prej 300 mw, të cilët do të përfitojnë masat mbështetëse që përshkruhen më poshtë. Autoriteti kontraktues më vonë mund të vendosë që të rrisë kapacitetin total të procedurës për përzgjedhjen e projekteve deri në 350 mw.

4. Lloji i procesit konkurrues: Procedurë e hapur.

5. Vendndodhja e projektit: E zgjedhur nga ofertuesi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Marrëveshja e blerjes së energjisë elektrike: Do të nënshkruhet për të gjithë kapacitetin total të ofertuesit të përzgjedhur kundrejt çmimit të energjisë elektrike (Tarifa e ofertuar nga pjesëmarrësit, duhet të jetë jo më shumë se 59.97 euro/MWH dhe të jetë e nivelizuar dhe e pandryshuar për një periudhë 15 vjet (pesëmbëdhjetë vjet) për një afat që fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon 15 vjet pas datës së operimit tregtar, duke përfshirë edhe rastin e konvertimit (d.m.th. marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike e lidhur fizikisht do të konvertohet në një kontratë për diferencë të likuiduar financiarisht) (sipas specifikimeve të parashikuara në dokumentet e procesit konkurrues).

7. Tarifa e regjistrimit për pjesëmarrje në procedurën konkurruese: Ofertuesit e interesuar, brenda 45 ditëve, por jo më vonë se data 28 shkurt 2024, ora 18:00 e Evropës Qendrore, duhet të kryejnë pagesën e regjistrimit për pjesëmarrje në procedurën konkurruese në vlerën 1,000 (një mijë) euro, në numrin e llogarisë së MIE-së të përcaktuar në dokumentet e procedurës konkurruese. Ofertuesit duhet të dërgojnë e-mail në adresën e personit të kontaktit, kopje të mandatpagesës.

8. Afati për dorëzimin e dokumentacionit për aplikim: 29 prill 2024, ora 18:00, ora e Evropës Qendrore.

9. Hapja e ofertave financiare: 10 korrik 2024

10. Informacion shtesë mbi dokumentet e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e projekteve për “Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e disa impianteve fotovoltaike, secili me një kapacitet të instaluar ndërmjet 10 mw dhe 100 mw (përfshirë), të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë”, mund të gjenden në website-in e autoritetit kontraktues: www.infrastruktura.gov.al

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Viola Haxhiademi